

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Gjykata Supreme e Kosovës
API.-KZI. Nr. 09/2009
Prishtinë
28 dhjetor 2010

Gjykata Supreme e Kosovës ka mbajtur seancën e kolegjit sipas Nenit 26, par. (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), dhe Nenit 15.4 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (LmK) më 28 dhjetor 2010 në objektin e Gjykatës Supreme në kolegjin e përbërë nga Kryetari i kolegjit Gerrit-Marc Sprenger dhe nga gjyqtari i EULEX-it Martti Harsia dhe gjyqtarët kosovarë Emine Mustafa, Nesrin Lushta dhe Salih Toplica, si anëtarë të kolegjit.

Nexhmije Mezini ishte procesmbajtëse,

Në praninë e

Prokurorit publik ndërkombëtar Jakob Willaredt, nga Zyra e Prokurorisë së Shtetit të Kosovës (ZPShK),

Avokatit E R si mbrojtës i të akuzuarit O Z

Në lëndën penale nr. API-KZI 09/2009 kundër të pandehurit:

O Z, i biri i S, dhe nënës A me mbiemër të vajzërisë H i lindur më në fshatin, komuna e Rahovecit, shqiptar kosovar, me adresën e fundit derisa ka qenë në liri në rrugën me profesion afarist, me shkollim të mesëm, i martuar, ka fëmijë, momentalisht në paraburgim në Qendrën e paraburgimit në Dubravë.

I dënuar në shkallën e parë me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren në lëndën P. Nr. 155/2007 të datës 17 prill 2008, të regjistruar në Shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Prizren të njëjtën ditë, **i pandehuri është shpallur fajtor për këto vepra penale:**

[i] Sepse më 10 tetor 2005 rreth orës 16:20 në tregun e fshatit Xërxë, komuna e Prizrenit, duke vepruar në bashkëpunim me bashkëkryerësin Sh Sh me qëllim të privimit të qëllimshëm nga jeta të H R, O Z ka shtënë me qëllim dhe ka vrarë H R në prani të personave të tjerë në mënyrë të dhunshme duke shfaqur mospërfillje të pamëshirshme për jetën;

Për kryerjen e veprës penale të **Vrasjes së rëndë**, në kundërshtim me Nenin 147, pika 5 e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), të kryer në bashkëpunim sipas Nenit 23 të KPPK-së, me një person tjetër, duke vrarë H. Rr. më 10 tetor 2005 në fshatin Xërxë, komuna e Prizrenit;

[ii] Sepse më 10 tetor 2005 rreth orës 16:20 në tregun e fshatit Xërxë, komuna e Prizrenit, duke vepruar në bashkëpunim me bashkëkryerësin Sh. Sh. me qëllim të tentativës së qëllimshme për të privuar nga jeta edhe N. Rr., O. Z. ka shtënë qëllimisht dhe ka plagosur N. Rr. në prani të personave të tjerë në mënyrë të dhunshme duke shfaqur mospërtullje të pamëshirshme për jetën;

Për kryerjen e veprës penale të **Vrasjes në tentativë**, në kundërshtim me Nenin 147, pika 11 dhe Neni 20 i KPPK-së, të kryer në bashkëpunim, sipas Nenit 23 të KPPK-së me një person tjetër, duke tentuar ta vrasë N. Rr. më 10 tetor 2005 në fshatin Xërxë;

[iii] Sepse më 10 tetor 2005 rreth orës 16:20 në tregun e fshatit Xërxë, komuna e Prizrenit, duke vepruar në bashkëpunim me bashkëkryerësin Sh. Sh. me qëllim të privimit të qëllimshëm nga jeta të H. Rr., O. Z. ka shtënë me qëllim dhe ka vrarë H. Rr.; dhe me qëllim të tentativës së qëllimshme për të privuar nga jeta edhe N. Rr. qëllimisht ka shtënë në H. Rr. dhe në N. Rr., duke mbajtur në posedim dhe në shfrytëzim armën për të cilën nuk ka pasur autorizim për posedim dhe për përdorim;

Për kryerjen e veprës penale të **Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve**, në kundërshtim me Nenin 328, par. 1 i KPPK-së, duke mbajtur në posedim dhe në shfrytëzim armën për vrasje dhe për vrasje në tentativë të vëllezërve Rr. më 10 tetor 2005 në fshatin Xërxë;

[iv] Sepse më 19 prill 2007, kur është arrestuar nga policia, ka qenë në posedim të armës për të cilën nuk ka pasur autorizim që ta posedojë apo që ta shfrytëzojë;

Për kryerjen e veprës penale të **Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve**, në kundërshtim me Nenin 328, par. 2 i KPPK-së, sepse ka qenë në posedim të armës kur është arrestuar nga policia më 19 prill 2007.

Dhe është dënuar si më poshtë:

I akuzuari është dënuar për veprën penale të **Vrasjes së rëndë** të kryer në bashkëpunim me dënim prej njëzet e pesë (25) vjet burgim [Neni 147, par. 5 dhe Neni 23 i KPPK-së]; për veprën penale të **Vrasjes në tentativë** të kryer në bashkëpunim me dënim prej njëzet e pesë (25) vjet burgim [Neni 147, par. 11; Neni 20 dhe 23 të KPPK-së]; për veprën penale të **Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve** [Neni 328 par. 1 i KPPK-së] me dënim prej gjashtë (6) vjetësh burgim dhe për shkak të **Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve** [Neni 328 par. 2 i KPPK-së] me dënim prej tre (3) vjetësh burgim.

Dënimi unik prej 25 vjetësh burgim është shqiptuar nga Gjykata e shkallës së parë në pajtim me Nenin 71, par. 1 i KPPK-së duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim që nga data 19 prill 2007;

I dënuar në shkallën e dytë me aktgjykimin e ndryshuar të Gjykatës Supreme të Kosovës (Ap-Kz Nr. 481/2008, të datës 21 korrik 2009) mbi ankesën e mbrojtjes kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prizrenit (P. Nr. 155/2007), të datës 17 prill 2008, si më poshtë:

[i] Ankesa e paraqitur në emër të **O. Z** më 4 gusht 2008 është PRANUAR pjesërisht 1) sa i përket cilësimit juridik të pikës 1 dhe 2, të cilat bashkohen dhe cilësohen si **Vrasje e rëndë** në kundërshtim me Nenin 147, pikën 11 të KPPK-së, të kryer në bashkëpunim sipas Nenit 23 të KPPK-së, për vrasjen e **H. Rr** në bashkëveprim me një person tjetër më 10 tetor 2005 në fshatin Xërxë, komuna e Prizrenit; dhe 2) sa i përket cilësimit juridik të pikës 3, pra **Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve**, në kundërshtim me Nenin 328, par. 2 të KPPK-së, për mbajtjen në posedim të armës më 10 tetor 2005 në fshatin Xërxë, komuna e Prizrenit, ndërsa:

[ii] ankesa e paraqitur në emër të **O. Z** më 4 gusht 2008 për pjesët tjera është REFUZUAR.

Avokatët mbrojtës të të akuzuarit kanë paraqitur ankesa kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 21 korrik 2009 (Ap.-Kz. Nr. 481/2009); ankesa e avokatit **E. R** është paraqitur më 3 shtator 2009 ndërsa ankesa e avokatit **F. C** më 8 gusht 2009, përderisa ajo e **T. G** është paraqitur më 8 shtator 2009. Është konstatuar nga të tre avokatët mbrojtës se Aktgjykimi përmban shkelje të kodit penal dhe se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit do të kundërshtohet. Përveç kësaj, avokatët mbrojtës **E. R** dhe **F. C** pohojnë shkelje esenciale të procedurës penale si dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Avokati **E. R** propozoi të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të lirohet i pandehuri nga vepra penale e **Vrasjes së rëndë** të kryer në bashkëveprim, ose eventualisht t'i shqiptohet një dënim më i butë për të gjitha veprat penale ose të anulohet Aktgjykimi dhe të kthehet lënda në rigjykim, ndërsa **F. C** kërkon që të anulohet Aktgjykimi P Nr. 155/2007 i Gjykatës së Qarkut të Prizrenit, të datës 17 prill 2008 si gjykatë e shkallës së parë dhe Aktgjykimi Ap.-Kz. Nr. 481/2008 i Gjykatës Supreme, si gjykatë e shkallës së dytë, i datës 21 korrik 2009 dhe të kthehet lënda për rigjykim në shkallën e parë; përfundimisht avokati **T. G** propozoi që të ndryshohet Aktgjykimi i Gjykatës Supreme i datës 21 korrik 2009 dhe të kthehet lënda për rigjykim dhe vendim të ri në Gjykatën Supreme, ose eventualisht të ndryshohet cilësimi juridik i veprës penale dhe të shqiptohet një dënim më i butë ose të shqiptohen njëra nga masat e zbatueshme për kryerësit me çrregullime mendore ose me kapacitet të kufizuar mendor siç përcaktohet me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/34.

ZPShK-ja, në përgjigjen e saj të datës 22 janar 2009 të regjistruar në Shkrimoren e Gjykatës Supreme të Kosovës më 25 janar 2009, i refuzoi të gjitha këto ankesa si të pabaza dhe propozoi që të njëjtat të hidhen poshtë dhe të vërtetohet Aktgjykimi i kontestuar që lidhet me **O** **Z**

Duke u bazuar në Aktgjykimin me shkrim të Gjykatës së Qarkut të Prizrenit në lëndën P. Nr. 155/2007 të datës 17 prill 2008 (të regjistruar në Shkrimore të gjykatës të njëjtën ditë), si dhe në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (Ap-Kz Nr. 481/2008, të datës 21 korrik 2009), pastaj në ankesat e dorëzuara me shkrim të avokatëve mbrojtës, të dhënat përkatëse nga shkresat e lëndës, dokumentet dhe parashtrirat me gojë të palëve gjatë seancës dëgjimore të 28 dhjetorit 2010, së bashku me analizën e ligjit në fuqi, Gjykata Supreme e Kosovës, pas këshillimit të mbajtur të njëjtën ditë, lëshon këtë:

AKTVENDIM

Ankesat e paraqitura nga Avokatët mbrojtës **E** **R** më 3 shtator 2009, **F** **C** më 8 gusht 2009 dhe **T** **G** më 8 shtator 2009 në emër të të pandehurit **O** **Z** **PRANOHET PJESËRISHT**. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë – Gjykatës Supreme të Kosovës AP.-KŽ. Nr. 481/2008, i datës 21 korrik 2009 **ANULOHET**. Lënda kthehet për rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë.

Pjesët tjera të ankesave REFUZOHEN.

ARSYETIM

Historia e procedurës

1. Pasditen e 10 tetorit 2005 rreth orës 16:20 në tregun e gjelbër të fshatit Xërxë, komuna e Prizrenit, dy kryerës duke vepruar në bashkëpunim iu afruan qytetarëve shqiptarë kosovarë **H** **Rr** dhe vëllait të tij **N** **Rr** të cilët ishin duke hyrë në veturën e tyre për të dalë nga tregu, ku kishin qenë me qëllim të blerjes së gjërave. Të dy kryerësit i drejtuan revolet e tyre në **H** **Rr**, qëlluan në të dhe e vranë. Njëri prej këtyre dy kryerësve, pasi e kishte qëlluar **H** **Rr** ia drejtoi revolen e tij edhe **N** **Rr** i cili me atë rast u plagos dhe më vonë u hospitalizua.

2. Dëshmitarët e identifikuan të pandehurin **O** **Z** si njërin nga qitësit i cili menjëherë pas qitjes u pa duke hyrë në një Opel Vectra me ngjyrë bordo nga ana e shoferit, e cila ishte e parkuar në atë mënyrë që të bllokonte veturën e viktimave, duke iu penguar atyre ikjen nga ai vend. Vetura Opel Vectra pastaj iku nga fshati Xërxë dhe u largua në drejtim të Gjakovës.

3. Më 12 tetor 2005, Prokurori publik i Qarkut të Prizrenit nxjerri Aktvendimin mbi fillimin e hetimeve kundër O Z si dhe ndaj kryerësit të dytë Sh Sh. Të njëjtën ditë u lëshua Urdhri për arrest nga Gjyqtari i procedurës paraprake të Gjykatës së Qarkut të Prizrenit. Më 19 prill 2007 O Z u arrestua nga policia e cila i gjeti në posedim një revole të tipit "Amadeo Rossi S.A. 0.38 Special", për të cilën nuk kishte autorizim. Prej asaj kohe ai është i paraburgosur.

4. Sa i përket kryerësit të dytë Sh Sh njëjti u arrestua më 23 maj 2007 pa asnjë incident nga Policia e UNMIK-ut dhe të njëjtën ditë ai u paraburgos me propozim të Prokurorit publik të qarkut duke u bazuar në një aktvendim të Gjykatës së Qarkut të Prizrenit (Hep. Nr. 52/07).

5. Më 16 korrik 2007, Prokurori publik i qarkut në Prizren e ngriti aktakuzën kundër të pandehurve O Z dhe Sh Sh (PP 230/2005), e cila u paraqit para Gjykatës së Qarkut në Prizren më datën 17 korrik 2007. Të dy të pandehurit u akuzuan për veprat penale të **Vrasjes së rëndë** të kryer në bashkëpunim [Neni 147, par. 5 dhe Neni 23 i KPPK-së]; **Vrasje në tentativë** të kryer në bashkëpunim [Neni 147, par. 11, Nenet 20 dhe 23 të KPPK-së]; veprën penale të **Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve** [Neni 328 par. 1 të KPPK-së], ndërsa vetëm kundër pandehurit O Z (edhe për veprën e **Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve** [Neni 328 par. 2 i KPPK-së]

6. Aktakuza u konfirmua në seancën e gjykatës së shkallës së parë më 30 gusht 2007 (KA 112/2007).

7. Shqyrtimi gjyqësor publik kundër të pandehurve O Z dhe Sh Sh i cili u mbajt në gjithsej nëntë (9) seanca ndërmjet 31 janarit dhe 17 prillit të vitit 2008, pjesërisht është mbajtur në lokalet e Gjykatës së Qarkut në Prizren dhe – duke pasur parasysh gjendjen shëndetësore të të pandehurit O Z – edhe në pjesë tjera si në sallën e gjykimit të Burgut të Dubravës. **Aktgjykimi dënues për Vrasje të rëndë** në kundërshtim me Nenin 147, par. 4, 5, dhe 8 të KPPK-së dhe për **Vrasje në tentativë** në kundërshtim me Nenin 147, par. 11 dhe Nenin 20 të KPPK-së, të dyja këto vepra të kryera në bashkëpunim sipas Nenit 23 të KPPK-së, si dhe për veprën e **Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve** në kundërshtim me Nenin 328, par. 1 të KPPK-së kundër të dy të pandehurve si dhe vetëm kundër të pandehurit O Z për shkak të **Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve** në kundërshtim me Nenin 328, par. 2 të KPPK-së **u shpall** më datën 17 prill 2008 me shqiptimin e një dënimi total prej njëzet e pesë (25) vjetësh burgim kundër secilit prej të pandehurve veç e veç.

8. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata e shkallës së parë i ka ekzaminuar të akuzuarit O Z dhe Sh Sh Pastaj, dëshmitarët në vijim janë marrë në pyetje: V B dhe S B, të cilit ishin në tregun e gjelbër në Xërxë, kur janë kryer veprat penale në fjalë, Policin e SHPK-së L V dhe ish Policjën e SHPK-së

F. D. të cilët e kanë hetuar vendin e ngjarjes dhe kanë marrë pjesë në hetime dhe autopsi lidhur me zhvarrosjen dhe djegien e trupit të viktimës H. R. në Rahovec disa ditë më vonë, viktimën N. R., Policin ndërkombëtar R. C. i cili ishte caktuar për të monitoruar dhe këshilluar në lëndën e vrasjes së H. R. dhe E. G., i cili ka qenë i përfshirë në arrestimin e të pandehurit O. Z. më 19 prill 2007, Policin e SHPK-së I. K. i cili ka qenë i përfshirë si ekspert i balistikës në hetimet lidhur me armën e gjetur te O. Z., gëzhojave dhe plumbave të gjetur në vendin e ngjarjes, gazetarin e gazetës Lajm Q. K. i cili ka ardhur në vendin e ngjarjes menjëherë pas të shtënave dhe i cili – në bazë të informatave që janë dhënë atij përmes një thirrje telefonike - ka botuar një artikull në gazetë më 14 tetor 2005, në këtë mënyrë duke i treguar emrat e të dy viktimave dhe se të pandehurit O. Z. dhe Sh. Sh. do të jenë kryerësit, Patologun e autopsisë Dr. Ananda Samarasekara i cili ia ka bërë autopsinë H. R., Kirurgun ortopedik dhe traumatologun Dr. S. D. i cili e ka mjekuar N. R. Policët e SHPK-së I. S., H. S., G., Xh. M., F. B., R. G. dhe I. B., të gjithë kanë qenë të përfshirë hetimet e krimit; Sh. K. punëtor në autolarje në Xërxë dhe Xh. Th. i cili punonte si shitës afër tregut në Xërxë dhe të që dy e kanë parë Sh. Sh. afër tregut në ditën e të shtënave, si dhe B. Z. gruan e të pandehurit O. Z.

9. Përveç kësaj, Kryetari i kolegjit vazhdimisht është konsultuar me stafin përkatës mjekësor në mënyrë që të sigurohet se i pandehuri O. Z. i cili vuan nga disa sëmundje fizike dhe psikologjike, do të jetë në gjendje fizike dhe mendore të përcjell gjykimin dhe të marr pjesë në atë mënyrë që i mundëson atij që ta kuptojë procedurën, konsultohet me avokatin e tij mbrojtës dhe t'i përgjigjet Gjykatës. Në veçanti, kardiologu Dr. J. M. është konsultuar si dhe internisti Dr. C. R. dhe D. M. dhe B. Për më tepër, i pandehuri O. Z. ka qenë në mënyrë të përhershme nën mbikëqyrjen e teknikut medicinal i cili i ka ofruar atij medikamentet e nevojshme dhe është siguruar që i pandehuri të hospitalizohet kurdo që ajo do të ishte e nevojshme.

10. Bazuar në këto dëshmi, gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike e cila ka çuar në dënim siç është cekur më parë. Në bazë të gjetjeve të saj, më 17 prill 2008, Gjykata e Qarkut ka shpallur aktgjykimin dhe ka shpall të akuzuarit fajtorë për veprat penale të cekura më lart nga pika [i] deri në pikën [iv]. Rrjedhimisht, Gjykata i ka shqiptuar të akuzuarve dënimin gjithashtu të specifikuar më lart.

11. Aktgjykimi është ankimuar me kohë, më 4 gusht 2008, nga të dy avokatë mbrojtës të të pandehurit O. Z., Av. E. R. dhe Av. R. G.

Më 29 tetor 2008, Avokati mbrojtës E. R. i ka përcjellë gjykatës një shkresë nga i pandehuri O. Z. dhe ka kërkuar që ajo t'i bashkëngjitet ankesës.

Gjithashtu, avokati mbrojtës i të pandehurit Sh. Sh. Av. R. H. me kohë ka paraqitur ankesë kundër aktgjyimit të Gjykatës së Qarkut të datës 11 gusht 2008.

12. Më 1 dhjetor 2008, ZPSHK-ja ka dhënë mendimin sipas nenit 409 paragrafit 2 të KPPK-së, duke propozuar refuzimin e të gjitha ankesave si të pabazuara dhe jomeritore. Prokurori publik nuk është ankuar.

13. Më 21 korrik 2009, pas dorëzimit të shkresave të lëndës të EULEX-i në janar 2009, Gjykata Supreme e Kosovës ka mbajtur një seancë për ankesa sipas nenit 410 të KPPK-së, në kuadër të së cilës ankesa e të pandehurit **O Z** e datës 25 tetor 2008 e bashkangjitur me ankesën e avokatit të tij mbrojtës është lexuar dhe parashtresat e avokatëve mbrojtës të të pandehurit **O Z**, Av. R G Av. E R dhe Av. F C gjithashtu janë dëgjuar si dhe parashtresa e të pandehurit **O Z** dhe mendimi i ZPSHK-së.

Për më tepër, gjithashtu janë dëgjuar parashtresat e të bashkëpandehurit **Sh Sh** dhe avokatëve të tij mbrojtës Av. R H dhe Av. H S.

14. Më 21 korrik 2009 kolegji për ankesa i Gjykatës Supreme të Kosovës ka shpallur aktgjykimin e saj (Az.-Kz. 481/2008) duke e pranuar pjesërisht ankesën e të pandehurit **O Z** sa i përket cilësimit juridik nën pikat 1 dhe 2 të aktgjyimit të shkallës së parë, të cilat janë cilësuar si Vrasje e rëndë në shkelje të nenit 147 pikës 11 të KPPK-së, dhe sa i përket cilësimit juridik nën pikën 3 të aktgjyimit të shkallës së parë, duke theksuar se i pandehuri **O Z** ka kryer vetëm veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 2 të KPPK-së. Pjesa e mbetur e ankesave është refuzuar dhe aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

15. I pandehuri **Sh Sh** është liruar nga të gjitha akuzat në mungesë të dëshmive.

16. Tre avokatët mbrojtës të **O Z** Av. E R, Av. F C dhe Av. T G me kohë janë ankuar ndaj aktgjyimit të kolegjit ankimor të Gjykatës Supreme të Kosovës të lëshuar në shkallën e dytë më 21 korrik 2009 (Ap.-Kz.Nr.481/2009). Ankesa e Av. E R është paraqitur më 3 shtator 2009, ankesa e Av. F C është paraqitur më 8 gusht 2009 dhe ankesa e Av. T G është paraqitur më 8 shtator 2009. Është konstatuar nga të tre avokatët mbrojtës se Aktgjykimi përmban shkelje të kodit penal dhe se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit do të kundërshtohet. Përveç kësaj, avokatët mbrojtës Av. E R dhe Av. F C pretendojnë në shkelje esenciale të procedurës penale si dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Av. E R ka propozuar ndryshimin e aktgjyimit të ankimuar dhe lirimin e të pandehurit nga akuza penale **Vrasje e rëndë** e kryer në bashkëkryerje ose t'i shqiptohet një dënim më i butë për të gjitha veprat penale ose të anulohet aktgjykimi dhe të kthehet në rigjykim, kurse Av. F C kërkon që të anulohet aktgjykimi P Nr. 155/2007 i Gjykatës së Qarkut në Prizren i datës 17 gusht 2008 si shkallë e parë, dhe aktgjykimi Ap.-Kz. Nr. 481/2008 i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 21 korrik 2009, si shkallë e dytë dhe çështje të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë; përfundimisht Av. T G ka propozuar të ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Supreme i datës 21 korrik 2009, të kthehet lënda në Gjykatën Supreme për rigjykim dhe rivendosje ose – në radhë të dytë – të ndryshohet cilësimi juridik i veprës penale dhe të shqiptohet një dënim më i butë ose të shqiptohen njëra nga

masat e aplikueshme për kryerësit me paaftësi mendore apo me aftësi të zvogëluar mendore të parapara me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/34.

17. **ZPSHK-ja** me përgjigjen e datës 22 janar 2009 të regjistruar në shkrimoren e Gjykatës Supreme të Kosovës më 25 janar 2009, në tërësi ka kundërshtuar të gjitha ankesat si të pabazuara dhe prandaj ka propozuar që ato të hedhen poshtë dhe të vërtetohet aktgjykimi i kontestuar që ka të bëjë me O **Z.**

GJETJET E GJYKATËS

A. Shkelja substanciale e dispozitave të Procedurës Penale

I. DISPOZITIVI I AKTGJYKIMIT TË SHKALLËS SË DYTË

Ad 1: Kuptueshmëria dhe përputhshmëria e dispozitivit:

18. Avokati mbrojtës E **R.** në ankesën e tij ka theksuar mendimin e tij se dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së dytë i mungojnë informatat e nevojshme, në veçanti lidhur me përshkrimin faktik të veprave penale dhe rrethanave nga të cilat varet zbatimi i dispozitave përkatëse të ligjit material, si dhe lidhur me qëllimin e kryerësit të pretenduar për të kryer krimet. Prandaj, **Gjykata Supreme ka shkelur nenet 403 paragrafin 1, pikën 11; 391 të KPPK-së.**

Ky kolegji i Gjykatës Supreme është i mendimit se dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së dytë së paku i përmbush kushtet minimale të KPPK-së dhe se është i kuptueshëm pasi që nuk është i dykuptimtë ose në kundërtënie me pjesën e mbetur të aktgjykimit të shkallës së dytë.

Në veçanti, neni 396 paragrafët 3 dhe 4 të KPPK-së përcaktojnë si në vijim:

(3) Dispozitivi i aktgjykimit përfshin të dhënat personale të të akuzuarit (neni 233, paragrafi 1 i këtij Kodi) dhe vendimin me të cilin i akuzuari shpallet fajtor për vepër penale për të cilën akuzohet, ose me të cilin lirohet nga akuza për atë vepër apo me të cilin refuzohet aktakuza.

(4) Kur i akuzuari është dënuar, dispozitivi i aktgjykimit përfshin të gjitha të dhënat e nevojshme të parapara në nenin 391 të këtij Kodi....

Neni 391 paragrafi 1 i KPPK-së – pasi që është relevant në lëndën në fjalë – shkruan si në vijim:

Gjykata, në aktgjykimin me të cilin të akuzuarin e shpall fajtor shënon:

1) Për cilën veprë shpallet fajtor së bashku me faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të Kodit Penal;

2) Emërtimin ligjor të veprës penale dhe dispozitat e ligjit penal të zbatuara gjatë marrjes së aktgjykimit; ...

Aktgjykimi përkatës i shkallës së dytë me lidhur me temën në diskutim shkruan si në vijim:

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës ... në procedurën penale kundër:

O **Z**, i biri i **A** dhe **H** i lindur më në fshatin Komuna e Rahovecit, shqiptar kosovar, me vendbanim në i martuar dhe ka fëmijë, afarist me profesion, ka të mbaruar shkollën e mesme, momentalisht në paraburgim në burgun e Dubravës; dhe

Sh i biri i **Sh** dhe **N** i lindur më në Komuna e Gjakovës, shqiptar kosovar, i martuar dhe ka fëmijë, me vendbanim në fshatin, me gjendje ekonomike mesatare, ka mbaruar shkollën e mesme, momentalisht në paraburgim në qendrën e paraburgimit në Dubravë.

Duke vendosur mbi ankesat kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarku në Prizren, P.nr. 155/2007, të datës 17 prill 2008, i cili i ka dënuar dy të pandehurit për kryerjen e veprave penale 1) vrasje e rëndë në bashkëkryerje, në kundërshtim të nenit 147 paragrafit 5 dhe nenit 23 të KPPK-së, 2) vrasje në tentativë në bashkëkryerje, në kundërshtim të nenit 147 paragrafi 11 dhe nenet 20 dhe 23 të KPPK-së, 3) Mbjajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 1 të KPPK-së, në fshatin Xërxë, Komuna e Prizrenit, më 10 tetor 2005, dhe **O** **Z** i vetëm për kryerjen e veprës penale 4) mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 2 të KPPK-së pas arrestimit të tij më 19 prill 2007, ankesat të cilat janë paraqitur nga avokatët mbrojtës në emër të **O** **Z** më 4.08. 2008 dhe në emër të **Sh** **Sh** më 11 gusht 2008.

.... Në seancën e mbajtur më 21 korrik 2009 dhe pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 21 korrik 2009, duke vepruar sipas nenit 420 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së) lëshon këtë

AKTGJYKIM

PRANOHET pjesërisht ankesa e paraqitur më 4 gusht 2008, në dobi të O Z 1) sa i përket kualifikimit ligjor të Pikës 1 dhe Pikës 2, të cilat janë unifikuar dhe kualifikuar si Vrasje e Rëndë në kundërshtim të nenit 147 pika 11 të KPPK-së, të kryer në Bashkëkryerje sipas nenit 23 të KPPK-së, në këtë, ai me një person tjetër më 10 tetor 2005 në fshatin Xërxë, Komuna e Prizrenit kanë vrarë H R dhe kanë tentuat ta vrasin N R dhe 2) sa i përket kualifikimit ligjor të Pikës 3, Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të Armëve, në kundërshtim të nenin 328 paragrafit 2 të KPPK-së, në këtë, më 10 tetor 2005 në fshatin Xërxë, Komuna e Prizrenit ai ka qenë në posedim të armës. Ankesa e paraqitur më 4 gusht 2008 në dobi të O Z REFUZHET në pjesën e mbetur.

Ankesa e paraqitur më 11 gusht 2008, në dobi të Sh i SH PRANOHET dhe i pandehuri LIROHET nga të gjitha akuzat.

....

Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, P. Nr. 155/2007, i datës 17 prill 2008, vërtetohet në pjesën e mbetur.

...

Duke e pasur parasysh se Aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së dytë në mënyrë të përpiktë i referohet brengave të ngritura nga mbrojtja kundër aktgjykimit të shkallës së parë, prandaj është në përputhje me dispozitat e nenit 415 paragrafit 1 të KPPK-së i cili përcakton se gjykata e shkallës së dytë shqyrton aktgjykimin në pjesën për të cilën është ushtruar ankesë, vlen të përmendet se në të vërtetë dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së dytë nuk është aq i qartë dhe i saktë sikur do të mund të ishte. Megjithatë, pa asnjë dyshim i plotëson të gjitha kushtet e nenit 396 paragrafit 3 të KPPK-së, pasi që aty në veçanti janë të dhënat personale të të akuzuarit në pajtim me nenin 233 të KPPK-së dhe vendimi me anë të të cilit është shpallur fajtor për veprën për të cilën ai është akuzuar.

Dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së dytë në veçanti nuk është aq i saktë dhe i detajuar siç do të mund të pritej, kur kemi të bëjmë me faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të ligjit penal, siç kërkohet nga neni 391 paragrafi 1 i KPPK-së.

Megjithatë, dispozitivi i Aktgjykimit të Shkallës së Dytë e cilëson veprën përkatëse si "Vrasje të rëndë në shkelje të Nenit 147 pikës 11 të KPPK-së, të kryer në Bashkëkryerje nën Nenin 23 të KPPK-së, ku ai [i pandehuri O Z me një tjetër vranë H R dhe tentuan ta vrasin N R më 10 tetor 2005 në Fshatin Xërxë,

Komuna e Prizrenit dhe 2) sa i përket cilësimit juridik të Pikës 3, Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në shkelje të Nenit 328 paragrafit 2 të KPPK-së, ku ai ishte në pronësi të armës më 10 tetor 2005 në Fshatin Xërxë, Komuna e Prizrenit”.

Përveç kësaj, një referim i plotë i bëhet Aktgjykimit të ankimuar të Shkallës së Parë të Gjykatës së Qarkut në Prizren, të datës 17 prill 2008, P Nr 155/2007, i cili u vërtetua në pjesët e mbetura.

Prandaj, ky kolegji i Gjykatës Supreme vëren se dispozitivi i Aktgjykimit të ankimuar të shkallës së dytë, edhe pse ka mundur të shkruhet më qartë, së paku është i qartë mjaft sa për t’ju bërë ballë kundërshtimeve mbi kuptueshmërinë dhe përputhshmërinë.

Ad 2: Kundërthëniet brenda dispozitivit dhe në mes kësaj të fundit dhe arsytimit të Aktgjykimit:

19. Përveç kësaj, Avokatët mbrojtës E R dhe F C potencuan se sipas mendimit të tyre ligjor dispozitivi dhe arsytimi i Aktgjykimit të Shkallës së dytë do të jenë kundërthënës me njëri tjetrin, pasi që – edhe pse bashkë i pandehuri Sh Sh: ishte liruar nga të gjitha akuzat, që qartë mund të lexohet nga dispozitivi – i pandehuri O Z ishte dënuar si bashkëkryerës dhe vazhdimisht do të adresohet sikur “bashkëkryerës” gjatë gjithë arsytimit të Aktgjykimit. Prandaj, **Gjykata Supreme ka shkelur Nenin 403 paragrafin 1, pikën 12 të KPPK-së.**

Ky kolegji i Gjykatës Supreme konstaton qartazi se nuk ka shenja të shkeljes së Nenit 403 paragrafi 1, pika 12 e KPPK-së, pasi që nuk mund të vërtetohet një kundërthënie e tillë e dispozitivit apo në mes të kësaj të fundit dhe arsytimit të Aktgjykimit, kur bëhet fjalë për cilësimin juridik të veprave penale të kryera nga O Z në Bashkëkryerje. Pavarësisht nga fakti se i pandehuri tjetër, Sh Sh: , ishte shfajësuar nga kolegji i shkallës së dytë për shkak të mungesës së dëshmive (që nuk do të diskutohet në këtë kontekst) asnjëherë nuk ishte kundërshtuar se – kur O Z ishte përfshirë në gjuajtje më 10 tetor 2010 në treg në fshatin Xërxë, Komuna e Prizrenit, - aty ishte një person i dytë i pranishëm, pra duke vepruar në bashkëpunim me të. Kjo ishte deklaruar në veçanti nga dëshmitari N Rr prej fillimit, madje edhe me rastin e parë të marrjes në pyetje nga Policia e UNMIK-ut më 21 tetor 2005, kur ai theksoi se ai kishte njohur vetëm të pandehurin O Z si qitës, por nuk e kishte të njohur identitetin e qitësit të dytë. Dëshmitari vazhdimisht iu referua pranisë dhe veprimeve të dy qitësve gjithashtu edhe pas kësaj në të gjitha rastet, sa herë që ishte marrë në pyetje. Përveç kësaj, edhe dëshmitari Rreshter i SHPK-së I B në ditën e kryerjes së gjuajtjeve, më 10 tetor 2005, kishte bërë një protokoll mbi marrjen në pyetje të dëshmitarit, i cili nuk dëshironte ta zbulonte identitetin e tij/saj dhe prandaj është i/e panjohur për Gjykatat. Megjithatë, edhe ky dëshmitar kishte deklaruar se dy qitës ishin të përfshirë në kryerjen e këtyre krimeve. Dëshmitari I B ka konfirmuar deklaratën e tij gjatë marrjes së tij në pyetje para Gjykatës së shkallës së parë më 11 prill 2008. Pasi që kolegji i shkallës së dytë në Aktgjykimin e tij ka konfirmuar Aktgjykimin e

shkallës së parë, ku veçanërisht dëshmitari N Rr ka deklaruar se O Z kishte drejtuar armën në viktimën H Rr dhe më pas e kishte drejtuar atë edhe në vetë dëshmitarin dhe përveç kësaj dëshmitari ishte konsideruar i besueshëm në këtë aspekt, cilësimi juridik i kolegjit të shkallës së dytë të Gjykatës Supreme sa i përket veprime që lidhen me gjuajtjet nga O i Z të kryera në bashkëkryerje është i drejtë.

II. KUNDËRTHËNIET DHE MANGËSITË E ARSYETIMIT SI I TILLË

20. Avokati mbrojtës E R përveç kësaj theksoi se arsyetimi i Aktgjykimit të shkallës së dytë si i tillë do të jetë kundërthënës në vetë, pasi që i adresohet të pandehurit O Z vazhdimisht si “bashkëkryerës”, gjersa jep arsyetim për shfajësimin e të pandehurit tjetër, Sh Sh i cili ishte akuzuar si bashkëkryerës. Po ashtu, do të ketë mangësi sa i përket fakteve vendimtare, veçanërisht kur kemi të bëjmë me çështjen e dashjes siç përcaktohet me Nenin 147 pika 11 e Kodit Penal të Kosovës (KPK). Po ashtu motivi i bazuar në rivalitetin familjar që lidhet me gjakmarrje nuk është marrë parasysh si duhet nga ana e Gjykatës Supreme. Prandaj, **Neni 403 paragrafi 1, pika 12 e KPPK-së do të shkelej nga Gjykata Supreme.**

Ky kolegji i Gjykatës Supreme nuk sheh asnjë shkelje të ligjit, në veçanti të Nenit 403 paragrafit 1, pikës 12 të KPPK-së. Deri më tani, referenca bëhet në atë se çka tanimë u tha nën pikën A.I. të këtij Aktgjykimi.

Sa i përket cilësimit juridik lidhur me Vrasjen e rëndë sipas Nenit 147 pikës 11 të KPK-së, referenca do të bëhet nën pikën C.II. të këtij Aktgjykimi, pasi që çështja konsiderohet të jetë e lidhur më shumë me subjektet e zbatimit të duhur të ligjit penal.

III. PESHIMI DHE VLERËSIMI I GABUAR I DËSHMIVE

Ad 1: Vlerësimi i deklaratave të dëshmitarit N Rr :

21. Avokati mbrojtës E R përveç kësaj është i mendimit se Aktgjykimi i kundërshtuar i shkallës së dytë nuk ka vlerësuar si duhet deklaratat e dëshmitarit N Rr, vëllait të plagosur të viktimës së ndjerë H Rr, pasi që ai konsiderohej si bindës sa i përket të pandehurit O Z, ndërsa Gjykata nuk i është bindur atij sa i përket rolit të të pandehurit Sh Sh.

Ky kolegji i Gjykatës Supreme vjen deri te mendimi se nuk është bërë asnjë vlerësim i gabuar i dëshmive, në veçanti përkitazi me diferencimet në raport me përgjegjësinë e dëshmitarit N Rr, as nga Gjykata e shkallës së parë e as veçanërisht nga kolegji i shkallës së dytë i Gjykatës Supreme.

Ekzaminimi i dosjes mundëson të kuptohet se Gjykata e Shkallës së Parë, siç është e theksuar edhe në Aktgjykimin e datës 17 prill 2008 (P. Nr. 155/2007), ka analizuar me

kujdes deklaratat e dëshmitarit dhe i ka peshuar ato përkitazi me të gjitha aspektet një nga një (f. 7 deri 9 versioni në gjuhën angleze dhe andej tutje).

Megjithatë, kolegji i shkallës së dytë erdhi te një rezultat tjetër sa i përket të pandehurit Sh. Sh. dhe mendimin e vet e ka shtjelluar në bazë të besueshmërisë së dëshmitarit N. Rr. në këtë mënyrë:

[A]... “gabimi eventual në procedurë i bërë nga ana e gjyqtarit të parë lidhur me pranimin e Sh. nuk do të thotë se deklaratat tjera të dëshmitarit lidhur me faktin dhe me të pandehurin tjetër nuk janë të besueshme. Arsyetimi i aktgjykimit të kundërshtuar e bën të qartë se N. Rr. e njihje O. Z. si pasi që ata ishin nga i njëjti fshat. ... Që nga momenti i parë i hetimeve policore N. ka deklaruar se O. Z. ishte njëri nga agresorët (shih dëshmitarin L. V.) pa asnjë ndikim të jashtëm të mëparshëm dhe vazhdimisht e ka përsëritur deri në shqyrtim gjyqësor” (f. 13 versioni në gjuhën angleze).

Sa i përket të pandehurit tjetër, Sh. Sh., Gjykata e shkallës së dytë erdhi deri te përfundimi se i pandehuri duhet të shfajësohet. Sa i përket dëshmitarit N. Rr., Aktgjykimi i shkallës së dytë qartazi potencon:

“N. Rr. i deklaroi menjëherë pas incidentit një polici (dëshmitar L. V.) se ka njohur njërin nga qitësit si O. Z. Deklarata e njëjtë është bërë nga Rr. në Polici në intervistën e parë të datës 11 tetor 2005 në spital.”

Pastaj, Aktgjykimi vazhdon analizën e deklaratave të ndryshme të dhëna nga N. Rr. më 11 tetor 2005, 27 tetor 2005, 08 korrik 2007 dhe në fund gjatë shqyrtimit gjyqësor më 2008. Kolegji i shkallës së dytë në këtë kontekst e ka bërë të qartë se siç duket dëshmitari N. Rr. së pari e ka njohur Sh. Sh. si qitësin e dytë, kur ishte intervistuar nga Policia më 08 korrik 2007, por jo më herët. Aktgjykimi i shkallës së dytë deri këtu i referohet këtyre aspekteve si dhe faktit që gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor dëshmitari në seancë jo publike kishte zgjedhjen në mes nëntë (9) personave për ta identifikuar të pandehurin Sh. Sh. i cili ishte i ulur me avokatin e tij mbrojtës në bankën e të pandehurit. Prandaj, kolegji i shkallës së dytë përfundon se “... kjo lejon dyshim të bazuar mbi këtë identifikim” (f.24 versioni në gjuhën angleze).

Ky kolegji i Gjykatës Supreme tërësisht vërteton këtë arsyetim si të qartë dhe të mjaftueshëm sa i përket vlerësimit të dëshmitareve lidhur me deklaratat e dëshmitarit N. Rr.

Ad 2: Refuzimi i kërkesës për rikonstruktim dhe trajtimi i rezultateve të ekspertizës balistike nga kolegji i shkallës së dytë:

22. Avokati mbrojtës E. R. i përveç kësaj theksoi – dhe këtij argumenti i bashkohet avokati F. C. gjithashtu – se Gjykata e shkallës së dytë kishte refuzuar kërkesën e Mbrojtjes për rikonstruktim sa i përket vendit të ngjarjes, edhe pse kjo ishte

justifikuar qartë me Nenin 254 të KPK-së. Kolegji i shkallës së dytë po ashtu tentoi të gjejë një shpjegim për rezultatet e ekspertizës balistike, duke pretenduar se janë përdorë dy lloje të armëve, njëra që qet jashtë municionin gjatë gjuajtjes dhe një tjetër që nuk e bën këtë. Megjithatë, kjo nuk mundi të bazohej në asnjë fakt e ekspertizë.

Sa përket Mbrojtjes ka theksuar se rikonstruktimi i vendit të ngjarjes ishte refuzuar nga Gjykata e shkallës së parë dhe Aktgjykimi i saj megjithatë ishte konfirmuar me Aktgjykimin e shkallës së dytë, edhe pse kërkesa ishte justifikuar në përputhje me Nenin 254 të KPPK-së, ky kolegji i referohet arsytimit siç është dhënë nga Gjyqtari i parë, duke theksuar se rikonstruktimi i vendit të ngjarjes asnjëherë më parë nuk është kërkuar nga Mbrojtja, veçanërisht jo gjatë hetimeve dhe fazës së procedurës paraprake, siç parashihet me ligj si rregull. Duket se kolegji i shkallës së dytë nuk ka parë nevojën për rikonstruktim, por e ka bazuar vendimin e vet në dëshmi tjera vërtetuese të ofruara sipas shkresave të lëndës. Kjo qartazi mund të kuptohet nga shtjellimet e gjera dhe të hollësishme që Gjykata e shkallës së dytë i ka ndërmarrë lidhur me këtë çështje (*f.14 deri 16 versioni në gjuhën angleze*).

Megjithatë, vlen të përmendet se Mbrojtja nuk ka shtjelluar mbi këtë çështje, se në çfarë rezultatesh, të ndryshme nga ajo që është vërtetuar deri më tani nga Gjykata, do të qonte rikonstruktimi i vendit të ngjarjes.

Edhe pse vlen të përmendet se spekulimet e kolegjit të shkallës së dytë mbi përdorimin e dy armëve të ndryshme, ku njëra prej tyre mund të kishte qitur jashtë gëzhojat e tjetra jo, duket se mungon përvoja lidhur me armët dhe prandaj kjo mund të dezorientojë, kjo nuk mund të shihet dhe nuk është potencuar nga Avokatët mbrojtës gjatë rrjedhës së ankesave të tyre përkatëse, se si ky aspekt do të kishte ndikim në konstatimet e Gjykatës.

Ad 3: Vlerësimi i gabuar i dëshmive

23. E fundit por jo më pak e rëndësishme, nuk do të kishte vlerësim individual dhe të përbashkët të dëshmive të marra në Aktgjykimin e shkallës së dytë, siç përndryshe parashihet me Nenin 387 paragrafin 2 dhe 396 paragrafin 7 të KPPK-së.

Pas kontrollimit me kujdes të dokumenteve përkatëse të shkresave të lëndës, kjo Gjykatë kupton se argumenti njëjtë ishte ngritur tanimë gjatë ankesave kundër Aktgjykimin të shkallës së parë. Prandaj, gjykata e shkallës së dytë veçanërisht ka theksuar në mendimin e saj se aspektet përkatëse të ankesës nuk do të jenë të bazuara, por se Aktgjykimi i kundërshtuar i shkallës së parë do të “vlerësojë dëshmitë mbledhura si veçmas ashtu (*f.6-17*) edhe si tërësi (*f.18-27*)” (*f.13 versioni në gjuhën angleze*).

Kjo Gjykatë plotësisht e ndan mendimin e Gjykatës së shkallës së dytë (edhe pse është shumë i shkurtër), pasi që analiza e Aktgjykimin të shkallës së parë e kryer në këtë dokumentacion qartë konfirmon vërtetimet përkatëse të Gjykatës së shkallës së dytë. Vlen të përmendet në këtë kontekst se natyrisht – pasi që Gjykata e shkallës së dytë ka

zgjedhur të mos marrë asnjë dëshmi përsëri – ri-vlerësimi i dëshmive duhej të bazohej në konstatimet e shkallës së parë.

IV. “PRANIMI” I O. Z.

24. Avokatët mbrojtës të të pandehurit, E. R. dhe F. C. në ankesat e tyre kanë potencuar se deklarata e O. Z. e datës 25 tetor 2008 e bashkangjitur ankesës në kërkesën e avokatit E. R. më 29 tetor 2008 nuk i plotëson kushtet për deklarim të fajësisë siç parashihet me ligj. Në veçanti Gjykata e shkallës së dytë e ka konsideruar deklaratën përkatëse të të pandehurit si një pranim i gjuajtjes pa ia dhënë atij mundësinë të pranojë krimet gjatë rrjedhës së procedurës ankimore. Në vend të hapjes së dëgjimit të ndarë me qëllim që t’i mundësohet të pandehurit sigurimi i mbrojtjes së tij, dëgjimi i të pandehurit lidhur me ankesën e tij ishte kryer vetëm gjatë seancës së rregullt ankimore. Me këtë, duke mos ia ofruar të pandehurit kushtet për gjykim të drejtë siç parashihet me Nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj), **Kolegji i ankesave i shkallës së dytë ka shkelur Nenin 403 paragrafin 1, pikën 9 të KPPK-së.** I pandehuri në veçanti është i privuar nga mundësia që të përshkruajë atë çka kishte ndodhur dhe cila ishte prapaskena e të gjitha ngjarjeve dhe të paraqesë një numër të caktuar të dëshmitarëve në favor të tij.

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se shqetësimet e ngritura nga Mbrojtja në këtë aspekt janë faktikisht të bazuara, pasi që deklarimi i fajësisë sipas dispozitave përkatëse të KPPK-së kërkon që i pandehuri të paralajmërohet si duhet dhe të dëgjohet versioni i tij për atë çka ka ndodhur dhe se a deklarohet fajtor veçmas për secilën pikë dhe se kjo duhet të bëhet gjatë shqyrtimit. Kjo nuk kishte ndodhur në këtë rast.

Gjykata e shkallës së dytë në Aktgjykimin e saj thekson siç vijon:

“Gjatë shqyrtimit gjyqësor i pandehuri kurrë nuk është deklaruar fajtor. Më 29 tetor 2008 avokati mbrojtës i O. Z., i përcjelli kësaj Gjykate një letër të datës 25 tetor 2008 nga i pandehuri e cila i ishte bashkëngjitur ankesës së tij. Në këtë letër i pandehuri shton se ‘pranon se ka vrarë H. Rr.’ (shëf i Shërbimit të Inteligjencës Serbe) dhe se ka plagosur vëllanë e tij.

... Gjatë seancës para kësaj Gjykate Z. deklaroi: ‘është e vërtetë se më 10 tetor 2005 ka ndodhur një vrasje dhe unë e kam kryer atë. Përveç paraqitjes së kësaj me shkrim, unë dëshirova ta bëj këtë edhe gojarisht’. Z. nuk dha asnjë detaj për faktet.

Kjo Gjykatë është e mendimit se kërkesa e shkruar dhe deklarata gojore e O. Z. paraqet një lloj pranimi të fajit dhe jo pjesë të re të dëshmisë, të cilat mund të merren vetëm në shqyrtim por jo gjatë seancës (412.1) Thjesht i pandehuri ka pranuar të ketë kryer vrasjen e H. Rr. dhe tentim vrasjen e vëllait të tij N. pa hyr në detaje të fakteve ose deklaruar mbrojtjen e tij. Për më tepër deklarata e O. Z. nuk ka

ndryshuar gjendjen faktike si përcaktohet nga gjyqtari i parë (f. 4 versioni në Gjuhën Angleze).

Në të vërtetë ashtu sikurse Gjykata e shkallës së dytë me të drejtë i referohet, Neni 411 paragrafi 2 i KPPK parasheh që “*gjykata e shkallës së dytë në seancë të kolegjit vendos nëse do ta mbajë shqyrtimin*”. Veç kësaj, Neni 412 paragrafi 1 i KPPK përcakton me sa vijon:

“Shqyrtimi para gjykatës së shkallës së dytë mbahet vetëm kur është e nevojshme që, për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, të merren prova të reja ose të përsëriten provat e marra më parë dhe kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme që lënda të mos i kthehet gjykatës së shkallës së parë në gjykim të serishëm.

Gjykata Supreme e Kosovës deri më tani konstaton se natyrisht – në kundërshtim me kuptimin e kolegjit të shkallës së dytë – pranimi i fajit duhet të konsiderohet si dëshmi në kuptim të ligjit. Kjo sqaron posaçërisht nga fakti se sipas Nenit 315 paragrafët 3 dhe 4 të KPPK në lidhje me Seancën e Konfirmimit (sikurse përsëritet në Nenin 315 paragrafët 2 deri 5 të KPPK për seancën e Shqyrtimit Gjqësor) gjyqtari mund të vazhdoj me vendimin e tij/saj në rast se ajo/ai është i kënaqur me pranimin e fajit përndryshe duhet të zhvilloj tërë procedurën e dëshmive më parë.

Ky arsyetim i Gjykatës Supreme po ashtu mbështetet nga komentimet mbi Ligjin për Procedurën Penale të Jugosllavisë (LPP) të vjetër në veçanti në Nenin 223 dhe 323 të LPP, të cilët që të dy përcaktojnë për pranimin e të akuzuarit, ose gjatë fazës së hetimeve (Neni 223 i LPP) ose gjatë Shqyrtimit Gjqësor (Neni 323 i KPP). Përderisa në të dy rastet tanimë ligji thotë se përveç pranimin të akuzuarit organi që zhvillon procedurat, në Shqyrtimin Gjqësor, gjykata ka “*detyrë po ashtu të mbledh/paraqes dëshmi të tjera*”, komenti qartë nxjerr në pah me sa vijon:

Kjo dispozitë [e Nenit 223 e LPP] vërteton se pranimi i të akuzuarit në të vërtetë është dëshmi në procedurat penale (Branko Petric; Koment mbi Ligjin e Procedurës Penale 1988; Botimi i tretë Gazeta Zyrtare e RSFJ, Beograd, Neni 223, nr. 1.).

Në kontekst të Nenit 323 të LPP, komentimet tregojnë se “pranimi i të pandehurit i cili është konsideruar si dëshmi më e lartë, ...është reduktuar tani në nivelin e çfarëdo dëshmie tjetër në procedurat penale. Kjo do të thotë se pranimi i të pandehurit është temë e vlerësimit kritik të lirë në lidhje me esencën e tij të brendshëm dhe përmbajtjen si edhe sa i përket lidhjes së saj komplekse me të gjitha dëshmitë e tjera të dëgjua dhe faktet e vërtetuara, sikurse çfarëdo dëshmie tjetër”. (Branko Petric; Koment mbi Ligjin e Procedurës Penale 1988; Botimi i tretë Gazeta Zyrtare e RFSJ, Beograd, Neni 323, nr.(1)).

Për më tepër Neni 315 i KPPK – të cilit i referohet Neni 359 i KPPK për Shqyrtimin Gjqësor - parasheh për pranim të fajit të vlefshëm që:

- i pandehuri kupton të drejtat e tij për të cilat është paralajmëruar;

- i pandehuri kupton aktakuzën;
- i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit;
- pranimi bëhet vullnetarisht nga i pandehuri pas këshillimeve të mjaftueshme me avokatin mbrojtës;
- pranimi i fajit mbështetet në faktet e lëndës;
- nuk ekziston asnjë rrethanë veç ndjekjes

Në këtë kuptim, i pandehuri duhet të pranoj fajësinë apo mos fajësinë për secilën akuzë, një nga një. Kur të gjitha këto kushte të plotësohen, gjyqtari mund të kërkoj qëndrimet e prokurorit publik, avokatit mbrojtës dhe palëve të dëmtuara.

Procedura qëllimore në mënyrë shtesë mund të sqarohet po ashtu me disa komentime të LPP të cilat natyrisht nuk e njohën instrumentin e pranimit të fajit deri në shkallën e afërt por ishte shtjelluar mjaft mirë sa i përket pranimit nga i akuzuari.

Për Shqyrtimin Gjyqësor, Neni 317 paragrafi 1 i LPP në veçanti i referohet “*dispozitave të cilat i takojnë marrjes në pyetje të akuzuarit në ekzaminimin preliminarë*” dhe në këtë mënyrë Neni 218 të LPP i cili në detaje shpjegon, sesi i akuzuari duhet të trajtohet në fushën e mëparshme dhe gjatë marrjes në pyetje. Komenti deri më tani në veçanti nxjerr në pah me sa vijon: :

“Pranimi, me qëllim të trajtimit të tij si të këtillë, duhet të përfshij, tërësisht, pranimin në të gjitha veprat dhe faktet (që është, mosveprimet), të cilat janë elemente thelbësore të veprës penale për të cilat akuzohet i akuzuari. Nëse i akuzuari pranon vetëm në një...ose disa veprime ose mosveprime që janë fakte, dhe nëse nuk pranon vetëm në një nga ato ose disa ... atëherë nuk është pranim në veprën penale, nëse mohimi i adresohet çfarë do element esencial të veprës penale. “(Branko Petric; Koment mbi Ligjin e Procedurës Penale 1988; Botimi i tretë Gazeta Zyrtare e RFSJ, Beograd, Neni 218, nr. III. 8))

Duke pasur parasysh pozicionin dhe rëndësinë e pranimit të fajit për vazhdimin e procedurës në zhvillim e sipër, kjo nuk mund të interpretohet ndryshe në kontekst të KPPK tani në fuqi. Në këtë kontekst është me rëndësi se sipas Aktgjykimit të shkallës së dytë *Z ka deklaruar ... por nuk ka dhënë ndonjë detaje për faktet (f. 4 versioni në gjuhën angleze).*

Fatkeqësisht, detajet e zhvillimit të seancës përkatëse të gjykatës së shkallës së dytë të datës 21 Qershor 2009 (Ap.-Kz. Nr. 481/2008) nuk mund të ri konstruktohen për shkak të faktit se procesverbali i seancës nuk gjendet më në shkresat e lëndës dhe nuk mund të gjendet në shkresat e dorës të ndjekjes. Ata kanë humbur.

Kjo është ajo që Gjykata vetëm mund të spekuloj mbi këtë çështje nëse Gjyqtari i ka kërkuar apo nuk i ka kërkuar pikëpamjet e prokurorit publik, avokatit mbrojtës dhe palëve të dëmtuara sikurse kërkohet me Nenin 315 dhe 359 të KPP në lidhje me pranimin e fajit. Për më tepër, mospasja në dispozicion e procesverbalit nuk mund të ri konstruktohet sa peshë i kishte dhënë kolegji i shkallës së dytë “pranimi” të pandehurit, duke vënë në dukje në arsyetimin e Aktgjykimit, se “*deklaratat e O Z, nuk e*

ndryshojnë gjendjen faktike sikurse përcaktohet nga gjyqtari i parë (f. 4 e versionit në gjuhën angleze).

Në rast se kolegji i shkallës së dytë do të kishte peshuar deklaratën e të pandehurit vetëm pak, pra vetëm duke njohur atë, por duke bazuar Aktgjykimin ndryshe në dëshmitë e marra gjatë Shqyrtimit Gjyqësor të shkallës së parë, mund të përfundohet se konsiderata shumë e vogël e "pranimit" dhe deklarata e O Z nga kolegji i shkallës së dytë nuk dëmtoi aspak rezultatet dhe konkluzionet e kolegjit, madje jo edhe në rastin kur palët nuk ishin ftuar për të dhënë mendimet e tyre mbi vlerën e deklaratës përkatëse. Megjithatë, kjo nuk mund të lexohet nga procesverbali më.

Duke pasur parasysh faktin se kolegji i tanishëm është shkalla e rregullt më e fundit për të vendosur mbi çështjen dhe atë sipas Nenit 430 paragrafi 2 të KPPK ky kolegji nuk duhet të zhvillojë asnjë shqyrtim, vendimi për kthimin e lëndës në shkallën e dytë konsiderohet të jetë mënyra më e përshtatshme e trajtimit të problemeve së afërmi.

B. Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike

25. Avokati Mbrojtës F C ka theksuar se refuzimi i kërkesës së rikonstruksionit i Mbrojtjes për vendin e krimit nga ana e Gjykatës së shkallës së dytë kishte pasur si rezultat se vërtetimi i gjendjes faktike ishte jo i plotë dhe i gabuar. Për më tepër, siç theksoi edhe Avokati Mbrojtës E R, kjo - së bashku me faktin se të pandehurit O Z nuk i është dhënë mundësia për të paraqitur dëshmitarë të shumta në favor të tij dhe për të përshkruar situatën sikurse ishte nga pikëpamja e tij - Gjykata Supreme nuk ka shtjelluar siç duhet mbi çështjen, nëse i pandehuri ka qenë duke vepruar në një situatë të mbrojtjes së nevojshme. Kështu, **Gjykata Supreme ka shkelur Nenin 402 paragrafi 1, pika 3, Neni 405 të KPPK.**

Ky kolegji i Gjykatës Supreme ka arritur në mendimin se një rikonstruksion i vendit të krimit jo domosdoshmërisht do të çonte në një rezultat të ndryshëm në lidhje me konstatimet e Gjykatës së shkallës së dytë mbi fajësinë e O Z. Përveç kësaj është e rëndësishme në këtë kontekst se edhe vetë Avokati Mbrojtës nuk e ka shtjelluar më shumë këtë pikë. Prandaj, referencë e plotë është bërë për atë çfarë tanimë u tha më lart nën pikën A. IV., Ad 2. të këtij Aktgjykimi. Përveç kësaj, për gjykatën në mënyrë që të ketë në konsideratë dispozitën ligjore në favor të pandehurit, e tillë si Mbrojtja e Nevojshme, i pandehuri të paktën ka për të siguruar një rrëfim të qëndrueshme dhe të besueshme që i mundëson gjykatës të vlerësojë nëse ndonjë dispozitë e tillë e favorshme ligjore mund të aplikohet. Në procedurat e tanishme mbrojtja nuk ka dhënë asnjëherë një përshkrim të ngjarjeve që mund të çojë në një përfundim të tillë.

C. Shkelje esenciale të Ligjit Penal

I LETRA E "PRANIMIT" E O Z

26. Avokati Mbrojtës T G ka theksuar mendimin e tij se letra e “pranimit” e të pandehurit O Z, e datës 25 Tetor 2008, do të ngrihte dyshime serioze në lidhje me besueshmërinë e saj, pasi sipas datës të letrës mbulesë të Avokatit Mbrojtës, që është 29 Tetor 2008, letra ishte regjistruar para se të ishte shkruar. Për më tepër, nën aspektet grafologjike mund të jetë e dyshimtë që O Z kishte shkruar letrën, pasi që nga shkrimi i dorës do dukej sikurse i ndonjë femre. Në fund por jo e fundit dhe vetëm në rast se letra ishte shkruar në të vërtetë nga vetë i pandehuri, Gjykata Supreme nuk e kishte konsideruar faktin se i pandehuri vuan nga depresioni dhe çrregullimi psikologjik, të cilat lehtë kanë mundur të shkaktojnë si rezultat që i pandehuri të pranoj, çfarë në realitet ai nuk e kishte bërë. Deri tani, Rregullorja e UNMIK-ut 2004/34, Neni 3 e datës 28 Gusht 2008 është dashur të konsiderohet dhe është shkelur nga Gjykata Supreme. .

27. Duke marrë parasysh letrën e “pranimit” të O Z e datës 25 Tetor 2008 bashkangjitur ankesës në kërkesën e Avokatit të tij Mbrojtës E R, ky kolegji i Gjykatës Supreme konstaton se pas asaj çfarë u tha më parë (pika A. IV. e këtij Aktgjykimi) pyetja, nëse letra tregon apo nuk tregon dorëshkrimin e O Z, mund të mbetet e hapur momentalisht, përkundër faktit se shumica e fjalëve të shkrimit të dorës mund të mos jetë e mjaftueshme për një ekspertizë grafologjike dhe pavarësisht nga informatat e dhëna nga ana e Avokatit Mbrojtës E R në letrën e tij mbulesë e datës 29 Tetor 2010, që në kontekstin e një vizite të Avokatit Mbrojtës në burgun e Dubravës më 28 Tetor 2010 “ i akuzuari O Z ka shprehur dëshirën e tij që t’i dorëzojmë këto në Gjykatën e Qarkut në Prizren, të nënshkruar si duhet prej tij ...” dhe se “ ... kjo letër është caktuar për në Gjykatën Supreme të Kosovës dhe e dërguar nëpërmjet Gjykatës së Qarkut në Prizren të shoqëruar me kërkesë që ajo të jetë e bashkangjitur në ankesën kundër Aktgjykimit C. nr. 155/2007 të datës 17.04.2007 të shqyrtohet së bashku me ankesën e parashtruar nga avokati”. Për më tepër, Avokati Mbrojtës në këtë kontekst shprehu shpresën e tij “... se letra e O Z do të përcillet si duhet për Gjykatën Supreme dhe do t’i bashkëngjitet ankesës...”

28. Në të vërtetë ishte vërtetuar se letra e të pandehurit O Z ishte regjistruar në Gjykatën e Qarkut në Prizren më 28 Tetor 2008, kurse letra mbulesë e Avokatit Mbrojtës më datë 29 Tetor 2008. Megjithatë, kjo mund të shpjegohet me një gabim në shtypje/shkrim të sekretarit të gjykatës në Prizren, pasi që nuk u kundërshtua gjatë seancave të shkallës së dytë, ku i pandehuri madje ka përsëritur përmbajtjen e letrës.

29. Sa i përket pyetjes mbi problemet psikiatrike të O Z, të cilat lehtë mund të kenë shkaktuar një situatë subjektive në të cilin i pandehuri pranon aktet, ai kurrë nuk e ka kryer vetë; referimi është bërë në atë që u tha më parë (pika A. IV. e këtij Aktgjykimi).

II. KUALIFIKIMI LIGJORE NGA GJYKATA SUPREME TË REZULTATEVE TË GJUAJTJES

30. Avokati Mbrojtës E. R. ka shprehur mendimin e tij që kualifikimi i vetëm një veprë penale **Vrasje e Rëndë në shkelje** të Nenit 147, paragrafi 1, pika 11 e LPK-së nuk do të jepej. Në veçanti, Gjykata e shkallës së dytë, derisa ka ndryshuar kualifikimin ligjor të pikave 1 dhe 2 të aktakuzës si u përjashtuan në Aktgjykimin e shkallës së parë, nuk dha hollësira për gjendjen ligjore të qëllimit për të vrarë, siç kërkohet nga Neni 147 pika 11 e KPK. Në vend të kësaj dhe në kundërshtim me atë që kishte gjetur Gjykata e shkallës së dytë, do të ishin dy vepra penale në pyetje, një Vrasje dhe një Tentim Vrasje, nga të cilat të paktën kjo e fundit nuk do të ishte e dënueshme aspak, pasi ajo nuk do të ishte një krim. Prandaj, **Gjykata e Supreme ka shkelur Nenin 404 paragrafi 1 i KPPK..**

Një analizë e kujdesshme e aktgjykimit të shkallës së dytë ndriçon se Gjykata e Shkallës së dytë ishte e nxitur nga shqetësimi se *"dënimi për dy akuza të ndryshme shkel ligjin penal në dëm të akuzuarit, sepse sipas dispozitave të Nenit 147 pika 11 të LPK-së këto dy fakte nuk mund të mbahen të ndara, por duhet të konsiderohen si vepër penale unike"* (f. 6 të versionit në gjuhën angleze e Aktgjykimit të shkallës së dytë).

Megjithatë, analiza e mëtejme e shkresave të lëndës dhe Aktgjykimit të shkallës së dytë shpie këtë Gjykatë në mendimin se në të vërtetë nuk ishin kryer shtjellime në lidhje me çështjen e një mundim të autorit (ve) të krimit, si formë e kualifikuar e *mens rea / dolus directus*, dhe siç kërkohet nga Neni 147 pika 11 e KPK. Gjykata e Shkallës së dytë mjaft hollësisht dhe bindshëm ka vënë në dukje pse Vrasja e Rëndë e supozuar dhe Vrasja në Tentativë e supozuar (pikat 1 dhe 2) duhet të konsiderohet si një Vrasje e Rëndë bazuar vetëm në Neni 147 pika 11 të LPK-së dhe se çdo kuptim tjetër do të ishte në dëm të pandehurit. Megjithatë, si një pyetje që rezulton nga mohimi i një qëllim siç kërkohet nga ligji, nevoja për përpunim do të dalë, pa marrë parasysh nëse ekziston apo jo një vrasje në tentativë e dënueshme në rastin në fjalë.

Një vështrim në dispozitat përkatëse të komentuar nga ligjet e vjetra penale të zbatueshme në Kosovë, veçanërisht Neni 47 të Kodit Penal të Serbisë (KPS), të cilit së voni i referohen të gjitha komentet e ligjit të Kosovës (si dhe Neni 30 paragrafi 2, nën paragrafi 2 të Kodit Penal të Krahinës Autonome të Kosovës (KSAK KP), pasi që në këtë aspekt ka qenë dispozita më e afërt me atë që është në fuqi tani), tregon se deri tani kanë parashikuar me sa vijon:

Neni 47 i KPS (në versionin e tij të vjetër):

(3) Dënimin nga paragrafi 2 i këtij Neni duhet të shqiptohet në personin i cili me paramendim kryen disa vrasje ..., pavarësisht nëse ata janë përpjekur për të gjitha këto vrasje me aplikimin e dispozitave të ujdisë, apo ata kanë qenë të dënuar më parë për një vrasje të caktuar.

Neni 47 i KPS-së (në versionin më të ri):

Me burg së paku dhjetë vjet ... dënohet: ...

6) *Kushdo që i privon nga jeta disa persona me qëllim të paramenduar dhe nuk paraqet vrasjen e momentit (çastit)...*;

Sipas formulimit të fjalëve të ligjeve përkatëse e gjithashtu të komenteve në dispozicion (të cilat natyrisht nuk janë të gjitha detyruese, por mund t'ju japin disa të dhëna), të gjitha këto dispozita, sikurse neni i aplikueshëm 147, Pika 11 e KPK-së i referohen vrasjeve me qëllim të paramenduar. Gjithashtu është e qartë që në të gjitha rastet jo vetëm një person mund të ndikohet nga vepra përkatëse penale.

Nga komentet (shpjegimet) mbi versionin e vjetër të nenit 47 paragrafit 3 të KPS-së siç është cituar më herët, mund të kuptohet që tradicionalisht të dy opinionet janë diskutuar se si të interpretohet ligji, prej të cilave njëra prej tyre nënkupton dispozitën “*e cilësuar si një formë të veçantë të vrasjes, e ashtuquajtur vrasje e shumëfishtë*”. Komentet – sa i përket lëndës në pyetje – nxjerrin në pah që kjo ka pasoja me shtrirje të gjerë, në veçanti në lidhje me ekzistencën e tentimit (të dënueshëm), i cili konsiderohet të jetë dhënë, “*kur autori i veprës me paramendim privon jetën e një personi dhe tenton të privoj jetën e një personi tjetër*”

“*Në bazë të opinionit tjetër, dispozita e paragrafit 3 ... e përshkruan dënimin për disa vrasje të paramenduara të kryera në bashkëveprim ose për vetëm një vrasje të paramenduar*”.

Megjithatë, gjithashtu qëllimi ishte që të zgjidhet dilema në rastin e konferencës së përfaqësuesve të sektorëve penal të Gjykatave Supreme të Republikës dhe të Sektorit Penal të Gjykatës Supreme të Jugosllavisë, e mbajtur më 26 dhe 27 dhjetor 1968 në Beograd, ku është përfunduar që paragrafi përkatës 3 “*paraqet dispozitën e lidhur me dënimin dhe jo dispozitën e cila parasheh formën e cilësuar të vrasjes nga paragrafi 1 i të njëjtit nen*”.

(*Srzentic, Nikola; Stajic, Dr. Aleksandar; Kraus, Dr. Bozidar, Lazarevic, Dr. Ljubisa; Djordjevic, Dr. Miroslav; Komentet (shpjegimet) mbi Ligjet Penale të Serbisë, KSA e Kosovës dhe KSA e Vojvodinës; 1981 in: “Savremena Administracija”; Belgrade; (neni 47, Pika 11 e KPS-së)*).

Gjithashtu, komentet e versionit më të ri të nenit 47 të KPS siç është cituar më parë nënvizojnë se “*kjo dispozitë zbatohet jo vetëm tek vrasjet e kryera por gjithashtu edhe te tentim vrasja*”. Megjithatë, ky koment vazhdon më tutje duke thënë se “*kjo vepër penale ekziston vetëm kur së paku dy apo më tepër persona kanë qenë të privuar nga jeta. Nëse vetëm një person ka qenë i privuar nga jeta dha ka pasur tentim për ta privuar jetën e një personi tjetër, kjo nuk do të përbëjë tentim vrasje prej pikës 6) nëse autori i krimit e ka paramenduar vrasjen e disa personave; nëse është e kundërta, kjo do të konsiderohet si një bashkëveprim i vërtetë në mes të vrasjes së kryer dhe tentim vrasjes*”.

(*Srzentic, Nikola; Ljubisa Lazarevic; Komentet e Kodit Penal të Serbisë, viti 1995; Botimi i 5-të: “Savremena Administracija”; Beograd; (neni 47, pika 9 e KPS-së)*).

Në sfondin e interpretimit të aktgjykimit të ankimuar të shkallës së dytë e gjithashtu edhe prej komentet e mësipërme, e në veçanti më i fundit, ky kolegji i Gjykatës Supreme kupton se pyetja nëse veprat penale përkatëse janë apo nuk janë të lidhura me të shtënat e H... dhe N... Rr... mund të cilësohen si një vrasje e rëndë në pajtim me nenin 147, pikën 11 të KPK-së është ende i hapur për shkak të faktit se Gjykata ende nuk ka shtjelluar mbi anën subjektive të krimeve dhe në veçanti qëllimit të kërkuar të autorit të veprës. Në rastin kur qëllimi për kryerjen e një Vrasje të Rëndë në pajtim me nenin 147 pikën 11 të KPPK-së nuk mund vërtetohet, do të nevojitet të diskutohet përsëri nëse atëherë dy veprat e ndara mund të cilësohen ligjërisht si një vrasje dhe një tentim vrasje, ose nëse interpretimi i ligjit siç është nxjerr në pah nga komentet e cituara më parë është ende i vlefshëm sipas ligjit të aplikueshëm deri në rezultatin se nuk ekziston tentim i dënueshëm për shkak të faktit se vetëm një person është vrarë.

III. PËRGJEGJËSIA PENALE E O... Z... NË KOHËN E KRYERJES SË KRIMEVE

31. Përfundimisht, të dy avokatët mbrojtës, F... C... dhe T... G... theksuan se përgjegjësia penale e të pandehurit në kohën kur janë kryer veprat penale, kurrë nuk është kundërshtuar nga Gjykatat dhe në këtë mënyrë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/34 nuk është marr parasysh.

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se ankesa në lidhje me këtë është e bazuar. Edhe pse çështja e përgjegjësisë penale të të pandehurit O... Z... kurrë nuk është ngritur nga mbrojtja më parë, as në shkallën e parë e as në shkallën e dytë, dhe si duket nuk është analizuar apo konsideruar fare deri më tani, çështja bie nën fushën e rishikimit ankimor dhe kështu që nevojitet të kontrollohet nga gjykata e shkallës së dytë madje sipas detyrës zyrtare në pajtim me nenin 415 paragrafin 1, pikën 2 e lidhur me nenin 404, pika 2 të KPPK-së.

Adresim (referim) i është bërë nenit 12 të KPK-së, i cili përcakton si në vijim:

- (1) Personi i cili ka kryer vepër penale konsiderohet i paaftë mendërisht nëse në kohën e kryerjes së veprës penale lëngonte nga një sëmundje mendore e përkohshme ose e përhershme, nëse kishte çrregullim mendor apo ngecje në zhvillimin mendor, që e ka prekur funksionimin e tij mendor, dhe, si pasojë e kësaj, nuk ka qenë në gjendje t'i kuptojë ose t'i kontrollojë veprimet a mosveprimet e tij apo të kuptojë se kryen vepër penale.
- (2) Person i cili ka kryer vepër penale konsiderohet se ka aftësi të zvogëluar mendore nëse në kohën e kryerjes së veprës penale aftësia e tij për të kuptuar apo për t'i kontrolluar veprimet a mosveprimet e tij ka qenë dukshëm e zvogëluar për shkaqet e cekura në paragrafin 1 të këtij neni. Personi i tillë konsiderohet penalisht përgjegjës, por këto rrethana merren parasysh nga gjykata kur vendos për kohëzgjatjen dhe llojin e sanksionit ose masën e trajtimit të detyrueshëm.

Në lëndën në fjalë, mund të kuptohet jo vetëm prej deklaratave mjekësore që në mënyrë të vazhdueshme i janë dhënë gjykatës lidhur me kushtet shëndetësore të O.

Z. gjatë seanca të ndryshme të shqyrtimit gjyqësor, por në veçanti nga ekspertizat psikiatrike me shkrim të dorëzuara në Gjykatë madje para se të fillonte shqyrtimi gjyqësor, se i pandehuri O. Z. ishte i ndikuar nga një numër i sëmundjeve të ndryshme si fizike ashtu edhe atyre psiqike. Në veçanti, psikiatri Dr. N. P. ka deklaruar në “Raportin Psikiatrik për Gjykatën” të datës 16 shkurt 2008 se i pandehuri O. Z. vuan nga “çrregullim personaliteti tipik-skizofrenik F 21”, i cili gjoja se tashmë i ka rrënjët që nga mesi i vitit të fundit të shkollës së mesme, dhe i cili – pasi që vëllai i tij ishte vrarë në luftë – është keqësuar edhe më tepër nga ky fakt. Diagnoza përkatëse gjithashtu e definuar si “*halucinacione hipnologjike dhe hipomaniake*” dhe ka theksuar se “*mendimet e tij janë të ndërhyra (penguara) nga përfytyrimet metafizike dhe [që] ai shpesh përdor fraza pseudo logjike dhe pseudo fizike [do të bëhet] i çuditshëm [dhe do të shfaq] ideja paranoide të viktimizimit dhe të fajësisë*”. Për më tepër, ekspertiza e pa datuar e Klinikës Psikiatrike të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës e cila është organizuar në bashkëpunim me psikiatrit Dr. J. M. dhe Dr. N. M. e gjithashtu me neurologun Prof. Dr. S. B., e cila është bazuar në kontrollimin psikiatrik të të pandehurit më 7 mars 2008 thekson se që nga viti 2000 gjendja e tij mendore ka ndryshuar, që ai vuan nga “*halucinacione hipnologjike dhe hipomaniake*” dhe ka shfaqur “*sjellje pseudo të çmendur*”. Si diagnozë është përcaktuar që i pandehuri vuan nga “Çrregullimi Stresor Post Traumatik (ÇTSD)” dhe shfaq “*ankthe të rënda dhe depression*”.

Të gjitha këto së bashku dhe ekspertiza tjetër si dhe dokumentacioni në shkresat e lëndës do ta kenë shpërë Gjykatën e shkallës së dytë në ekzaminimin sipas detyrës zyrtare të përgjegjësisë penale të të pandehurit në kohën kur krimet janë kryer.

D. Vendimi mbi dënimin

32. Të tre avokatët mbrojtës të të pandehurit O. Z. kanë theksuar që dënimi i shqiptuar është i pavend dhe nevojitet që seriozisht të zvogëlohet (ulet). Në veçanti, dënimi prej gjashtë (6) vjetëve për posedim ilegal të armëve, që është shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë dhe e konfirmuar nga paneli i shkallës së dytë, do të ishte në mënyrë qesharake i lartë dhe që kurrë më parë nuk është shqiptuar nga ndonjë gjykatë e Kosovës. Për më tepër, dënimi unik i krejt njëzet e pesë (25) vjetëve do të nënkuptonte burgim të përjetshëm për të pandehurin, duke marr parasysh moshën e tij që tashmë është 47 vjeçar. Do të ishte e rëndësishme që Gjykata Supreme në aktgjykimin e kundërshtuar Ap.Kz. nr. 481/2008, të datës 21 korrik 2009 ka dhënë arsye se dënimi i shqiptuar është afër minimumit të burgimit të përjetshëm, i cili do të ishte njëzet e një (21) vjet, por në vend të kësaj dënimi minimal siç parashihet nga neni 147 paragrafit 1, pikës 11 të KPK-së do të ishte vetëm së paku dhjetë (10) vite.

Vendimi mbi dënimin duket i drejtë, i udhëhequr në mënyrë të rregullt dhe jo i pazakontë derisa mund të bazohet në gjetjet e gjykatës së shkallës së dytë. Deri më tani, ky kolegji i Gjykatës Supreme e ndan vlerësimin e bërë nga kolegji i shkallës së dytë, i cili ka

konfirmuar vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë. Megjithatë, asnjë shtjellim tjetër nuk mund të bëhet në fazën e tanishme të procedurës, pasi që shqiptimi i dënimit duhet të konsideroj një numër të aspekteve të reja që duhet të analizohen nga gjyqtari i procedurës paraprake, pasi që ekziston në veçanti përgjegjësia penale e të pandehurit O. Z. dhe çështja e kualifikimit ligjor të dy veprave penale të lidhura me të shtëna që kanë të bëjnë me viktimat H. Rr. dhe N. Rr. siç janë përmendur më herët.

E. Përfundimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

33. Për shkak të arsyeve të lartpërmendura, Gjykata Supreme përfundon se ankesat e mbrojtjes së të pandehurit O. Z. janë pjesërisht të bazuara.

Kjo në veçanti i referohet pranimit të mundshëm të vrasjes së Hasan Rrustemit dhe të tentim vrasjes së N. Rr. nga i pandehuri O. Z. në lidhje me të cilën procedura ligjore e ofruar nga kolegji i shkallës së dytë (lexo pikën A. IV. të këtij aktgjykimi) nuk është kryer në pajtim me KPPK-në.

Për më tepër, Gjykata e shkallës së dytë ka dështuar të kontrolloj për pyetjen nëse i pandehuri O. Z. ka qenë apo jo i penalisht i besueshëm në kohën kur janë kryer veprat penale përkatëse të të shtënave në H. Rr. dhe N. Rr. Prandaj, është bërë shkelje e neni 415 paragrafi 1, pika 2 e lidhur me nenin 404, pika 2 e KPPK-së pasi që ekzaminimi në veçanti nga kolegji i shkallës së dytë nevojitet të kryhet sipas detyrës zyrtare, kurdo qoftë dhe në cilëndo mënyrë që kjo shfaqet në rastin përkatës (lexo pikën C.III. të këtij aktgjykimi). Për këto arsye të lartpërmendura, aktgjykimi i kolegjit të shkallës së dytë të Gjykatës Supreme duhet të anulohet dhe që lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së dytë për ri-shqyrtim dhe rigjykim.

E fundit por jo më pak e rëndësishme, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se kualifikimi ligjor për vrasjen e H. Rr. dhe të shtënat në dhe plagosja e N. Rr. nevojitet të marr parasysh çështjen e paramendimit dhe qëllimin e autorit të krimit e që nuk është shtjelluar nga gjykata e shkallës së dytë.

Përfundimisht, konsiderimi i sërishëm i çështjeve të adresuar më lart mund të shpie gjithashtu në domosdoshmërinë e rivlerësimit për shqiptimin e dënimit.

Si pasojë dhe pasi që sipas nenit 430 paragrafit 2, fjalisë 2 të KPPK-së, Gjykata Supreme si gjykatë e shkallës së tretë mund të mos të mos mbaj asnjë seancë dhe kështu është e parandaluar nga ligji që në mënyrë të drejtpërdrejtë të marr dëshmi, Gjykata Supreme ka vendosur në pajtim me nenin 430 paragrafin 2 e lidhur me nenet 420 paragrafin 1, pika 2, dhe 424 të KPPK-së.

Nga arsyet e lartpërmendura Gjykata Supreme vendosi si në dispozitiv.

Gjykata Supreme e Kosovës
API.-KZI. Nr. 09/2009
Prishtinë
28 dhjetor 2010

Anëtare e kolegjit

Emine Mustafa

Anëtare e kolegjit

Nesrin Lushta

Anëtare e kolegjit

Martti Harsia

Anëtare e kolegjit

Salih Toplica

Kryetar i kolegjit

Gerrit-Marc Sprenger

Procesmbajtësi

Holger Engelmann